

VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

Vendimi 2020/S01

Data: 11.04.2020

Organizimi i Kursit Administrativ

Bazuar në vendimin e bordit 2020/21, merret vendim për të mbajtur kursin administrativ më 17-18 prill 2020.

Në kurs do të ftohen të gjithë përfaqësuesit e klubeve ku ligjërues do të jenë 1. Fjolla Ibishi- Sekretare, 2. Mërgime Mula- Komisionere e Garave.

Kursi do të zhvillohet online përmes platformës ZOOM.

Vendimi 2020/23

Data:05.05.2020

Kërkesa në KOK për lejimin e ushtrimeve të tenisit nga data 18 maj

Me shumicë votash miratohet kërkesa dhe udhëzuesi për rikthimin në tenis t për lejimin e ushtrimeve të tenisit nga data 18 maj, bazuar në ftesën e pranuar nga KOK.

Vendimi 2020/K03

Data: 10.05.2020

Sfida “Play&Stay Home”

Kryetari Rexhepi merr vendim të organizohet sfida “Play&Stay Home” në kohën e pandemisë. Gara do të jetë e hapur për të gjithë tenistët por e ndarë në “ROG” dhe “Të rriturit”, të cilat do të përmbajnë realizmin e ushtrimeve të cilat do të demontohen nga tenistja Vesa Gjinaj.

Tenistët mund të ushtrojnë për videot e tyre 7 ditë ndërsa mund të hyjnë në garë nga data 04-06 maj.

Vendet e para në ROG për secilin ushtrim shpërblehen me nga një reket ndërsa të rriturit me nga 100 EUR. Të gjithë tenistët për pjesëmarrje në garë do të shpërblehen me nga një kuti topa.

Vendimi 2020/24

Data: 12.05.2020

Komisioni Vlerësues për sfidën “Play&Stay Home”

Miratohet me shumicë votash komisioni vlerësues i sfidës “Play&Stay Home”, i përbërë nga 3 anëtarë 1) Fatos Bejta, 2) Driton Latifi, 3) Osman Reçica, në përputhje me paragrafin 6.6 të Statutit të FTK-së.

Anëtarët e komisionit do të përcaktojnë kriteret për vlerësimin e videove më të mira të dërguara dhe do të shpallin fituesit në një afat prej 7 ditësh.

Vendimi 2020/25

Data: 02.06.2020

Rikthimi i tenisit pas Covid-19

Federata e Tenisit e Kosovës aprovon lejimin e ushtrimeve për klubet e tenisit pas shkëputjes 2 mujore si pasojë e pandemisë Covid- 19.

Ky vendim merret pas rekomandimit të pranuar nga presidenti i KOK z. Besim Hasani, i cili propozon që çdo federatë, klub, sportist apo zyrtarë mund të fillojë me ushtrimet sportive duke u përmbajtur rekomandimeve nga OBSH-ja dhe MSH/IKSHPK

Të gjitha klubet e tenisit pas këtij vendimi janë të lejuara të fillojnë me ushtrimet duke i'u përmbajtur po ashtu udhëzuesit “Për rikthimin e Tenist” i hartuar nga FTK në përputhje me rekomandimet e OBSH dhe Komisionit të ITF për Shkenca Sportive & Mjekësi.

Vendimi 2020/K04

Data:12.06.2020

Mëditja për angazhimin e trajnerit kondicional Fatos Bejta në kohën e pandemisë

Kryetari Rexhepi merr vendim që trajneri Kondicional Fatos Bejta të kompensohet me mëditje sipas pikës 17.4 të rregullores #03 për angazhimin e tij me ushtrime kondicionale për tenistët dhe trajnerët nga data 04-29 maj, në kohën e pandemisë “Covid 19”.

Z. Bejta në mënyrë vullnetare është angazhuar që nga java e parë e muajit prill me mbi 100 orë angazhim, ku një pjesë e orëve është kompensuar nga përkrahja e z.Bejtës në certifikim për trajner kondicional, ndërsa pjesa e dytë do të i kompensohet sipas rregullores #03.

Vendimi 2020/26

Data:13.06.2020

Shpërblimi i më të mirit të vitit

Miratohet me shumicë votash shpërblimi i më të mirit të vitit 2019, Granit Bajraliu. Shpërblimi ishte paraparë të realizohet pas shpallës së më të mirëve mirëpo për shkaqe financiare të vështirësuar u pamundësua të realizohet më herët.

Z.Bajraliu do të shpërblehet si më i miri i vitit me 550 euro neto.

Vendimi 2020/K05

Data:13.06.2020

Kampi për grupmoshat U16 dhe ekipin e Davis Cup në Ulqin

Kryetari Rexhepi miraton propozimin për organizmin e një kampi për tenistët më të mirë të grupmoshave U16 dhe ekipit të Davis Cup, e paraparë edhe në plan buxhetin 2020.

Kampi do të mbahet në klubin e tenisit “Bellvue” në Ulqin, nga data 24-30 Qershor. Në kamp do të marrin pjesë 6 tenistët më të mirë të grupmoshës U16 dhe kandidatët për reprezentues të Davis Cup.

Në kamp shoqërues do të jenë: 1.Jeton Hadergjonaj (Kapiten i ekipit të Davis Cup), 2). Fatos Bejta (Trajneri kondicional) dhe 3. Shkelzen Domi (Kordinator i Kampit).

Kamp zgjatë gjithsejtë 7 ditë, ndërsa kompensimi në mëditje realizohet sipas rregullores #03 pika 17.4.

Vendimi 2020/K06

Data:16.06.2020

Komisioni vlerësues i rregullores #5 për gara

Me vendimin e Kryetarit emërohet komisioni për rishikimin e rregullores #05 për garat e federatës dhe rregullat përkatëse, në përputhje me paragrafin 6.6 të Statutit të FTK-së.

Në komision emërohen:

1. Arian Ibrahimimi - Selektor, U14
2. Arzen Rifati - Anëtar i KRTK-së

3. Jeton Hadërgjonaj - Trajner Nacional
4. Lorik Haxhishabani - Selektor, U12
5. Mërgime Mula - Komisar i Garave
6. Shkelzen Domi - Ish kryesues i Këshillit Profesional
7. Tarkan Kosova - Kryetar i KRTK-së

Vendimi 2020/K07

Data:22.06.2020

Zhvendosja e Kampi për grupmoshat U16 në Pejë dhe shtyrja e kampit për ekipin e Davis Cup

Bazuar në vendimin e Kryetarit Rexhepi 2020/K05 për organizimin e Kampit për U16 dhe për ekipin e Davis Cup në Ulqin , merret vendim që kampi të zhvendoset në Pejë për shkak të situatës pandemike dhe vendimeve të reja të qeverisë së Malit të Zi, ndërsa kampi për reprezentuesit e Davis Cup do të shtyhet për një datë të pacaktuar.

Kampi për grupmoshat U16 do të mbahet nga 01-04 Korrik në Brestovik Pejë, ku do të marrin pjesë gjithsejtë 12 tenistët më të mirë të rankuar (4 vajza dhe 8 djem).

Në kamp shoqërues do të jenë: 1.Granit Bajraliu (Selektor për U16) 2), Fatos Bejta (Trajneri kondicional) dhe 3. Shkelzen Domi (Kordinator i Kampit).

Mëditjet pasojnë sipas rregullores #03 pika 17.4.

Vendimi2020/27

Data:22.06.2020

Sistemi i ri i rankingut gjatë periudhës “Covid-19”

-Miratohet me shumicë votash propozimi për ndryshimin e pikëve të rankingut gjatë periudhës së pandemisë “Covid-19”.

Ndryshimet e miratuara janë:

1. Të vlejnjë pikët e turneve të fituara nga tenistët që nga turneu i parë i vitit 2019, duke llogaritur pikët e fituara gjatë 104 javëve të fundit.
2. Ndër këto rezultate, në rankim do të përfshihen rezultatet nga 6 turnetë ku tenisti ka fituar më së shumti pikë.

3. Për tenistin që ka ndërruar grupmoshën, në përzgjedhjen e 6 turneve për qëllime të pikës 2, prioritetet kanë turnetë e grupmoshës së re që tenisti i ka luajtur. Në rast se tenisti i ka luajtur më pak se 6 turne në grupmoshën e re, atëherë turnetë e mbetura plotësohen me turnetë e grupmoshës paraprake.

4. Për shkak të dallimit të madh në pikëzime në mes të kategorisë U16 dhe U 18, pika 3 e këtij propozimit, në rastin e kalimit prej kategorisë U16 në kategorinë U18, modifikohet si në vijim: Pikët e fituara vitin e kaluar në kategorinë U16 pjesëtohen me faktorin 14, për t'i bërë të përafërta pikët e të dyja kategorive.

Ky ndryshim vlen nga java 27 e vitit 2020 deri në javën 26 të vitit 2021.

Vendimi 2020/28

Data:24.06.2020

Shtyrja e turneut “Peja Kids 2020

Miratohet me shumicë votash propozimi i K.T. Peja për shtyrjen e turneut “Peja Kids 2020” që ishte paraparë të mbahet më 27-28 Qershor në Brestovik-Pejë. Turneu shtyhet në një afat të pacaktuar për shkak të situatës pandemike në vend dhe ndjeshmërisë në kategorinë ROG.